

## **AKT THEMELIMI**

Në Tiranë, sot më datë 04.10.2024, në cilësinë e ortakut të vetëm, shoqëria “**TLS Shpk**”, një shoqëri tregtare, përfaqësuar nga administrator i saj **Z Vebian Muçaj**, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me nr **ID J00620062B** , me vullnet të lirë dhe të plotë harton Statutin për themelin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “**TLS Shpk**”.

### **Neni 1 Krijimi**

Shoqëria “**TLS Shpk**”, është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, më poshtë e quajtur shoqëria.

### **Neni 2 Perrsonaliteti Juridik**

Shoqëria fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**TLS Shpk**”, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i vetëm, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Kontributi i ortakut të vetëm përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

### **Neni 3 Selia**

Shoqëria ka selinë kryesore në adresën **Rr. “Shemsi Haka, nr.16, Tirane”**.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hap zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë, vetëm me vendim të ortakut të vetëm.

### **Neni 4 Objekti Veprimtarisë**

Shoqëria ka për objekt aktivitetin: “Agjensi marketingu, shërbime konsulence, krijim dhe menaxhim i fushatave publicitare, Dhenie me qera pajisjesh: audio, ndricim, video, ledwall/ekran led, kamera, podium, skena, sisteme perkthimi, sisteme konference etj per evente (aktivitete) te ndryshme. Asistence teknike, artistike dhe menaxheriale. Organizim evente, konferenca, trajnime, seminare biznesi, panairë, koncerte, regjistrim audio&video, shërbim fotografie, kamera (video),

montazh. Konceptim dhe realizim skenografi eventi, realizim objekte dekori për hapësira publike, tregtim element dekori sezonal. Nenkontraktim (qeradhenie) pajisje mbeshtesese per aktivitete te ndryshme, duke perfshire edhe efektet speciale dhe pajisjet piroteknike brenda kufijve te parashikuar nga ligji. Menaxhim projekti. Menaxhim i platformave te ndryshme online. Tregtim i produkteve promocionale. Shitje, blerje, tregti me shumice dhe pakice paisjesh audiovizuale.

Gjithashtu shoqeria mund te ushtroje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.”.

## **Neni 5 Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin më sipër një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në QKB.

## **Neni 6 Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë), lekë të reja, i ndarë me një kuotë.

Ortaku themelues, **Z. Vebian Muçaj**, është zotërues i një kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit.

## **Neni 7 Organet Vendimarrëse**

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë

Ortaku i Vetëm është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit, sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Cdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKB, për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Adminstrator i shoqërisë është **Z. Vebian Muçaj**

**Neni 8**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 9**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij akti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Tiranës.

**Neni 10**  
**Dispozita perfundimtare**

Ky Akt Themelimi, realizohet në 4 kopje.